



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ .02.2024

Lënda: Përgjigje

Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Shkodër
Adresa: Rruga “Marin Bacikemi” Sheshi “Gjon Pali II”

SHKODËR

E nderuar znj. P!

Në përgjigje të kërkesës tuaj për vënie në dispozicion të dokumentacionit arkivor nr. 15/1 prot datë 17.01.2024 (tonën nr 100 prot., datë 19.01.2024) dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, me anë të së cilës në referencë të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, kërkohet bashkëpunimi për të aksesuar dhe përdorur dokumentacionin fotografik, planimetrinë e objektit, prerje fasadë si edhe dokumente relevante që dispozonohen për objektin ish - Burgu i Spacit Monument Kulture Kategoria II (2007) me qëllim përgatitjen e tabelave orientuese të sinjalistikës në sitin kulturor, ju informojmë se:

Baza ligjore në kërkesën tuaj, është vendosur bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”.

Por nga shqyrtimi i kërkesës, vërehet se aksesimi në dokumentacionin nënshtror të dispozitave të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar, dhe jo dispozitave të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”.

Ligji nr. 45/2015, normon veprimtarinë funksionale të Autoritetit, si ligj i posacëm, dhe gjen zbatim në këtë pikë duke preluar mbi ligjin nr. 119/2014, i cili zbatohet për atë që është e mundur dhe nuk bie ndesh me ligjin organik, por edhe me ligjin për arkivat pasi **informacioni dhe dokumentacioni që kërkohet për vënie në dispozicion lidhet me vënie në dispozicion të të dhënave të fondit arkivor, dhe jo me informacion publik.**

Sa më sipër, Autoriteti trajtoi kërkesën në mbledhjen e datës 05.02.2024 dhe rekomandon të plotësohet formulari për aplikim nga studiues-media në zbatim të Udhësuesit për studiues-media, (i gjeni bashkëlidhur shkresës), të dyja të miratuara nga Autoriteti, me qëllim adresimin e kërkesës tuaj, në dispozitën e përcaktuar nga ligji nr. 45/2015, e më pas marrjen e informacionit dhe dokumentacionit.

Për çdo informacion mund të kontaktoni në Autoritet me : Dr. O.A. – Drejtor i Drejtorisë së Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar, tel: _____.

Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit

L. Cocoli

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Sofi Noti